UNION BUSINESS
Albanisch & Deutsch

NEWSLETTER

TETOR 2024

PANAIRI
I BIZNESEVE ME PRONARE GRA

UNION FOR BUSINESS woman

UNION BUSINESS
Albanisch & Deutsch

albi MALL

PËRMBAJTJA

- Trendet e investimeve në Gjermani 2
- Anëtarët e rinj 3
- Aktivitetet e Unionit 5
- Dritarja e Diasporës 9
- Statistika/Kosovë 11
- A e dini se... 14
- Statistika/Shqipëri 15
- Termi i këtij numri 16
- Statistika/Gjermani 17
- Arsyet për të investuar në Kosovë 20
- Përfitimet e anëtarëve 21
- Profili i anëtarëve 23

"Nuk ka rëndësi sa herë rrëzohesh, por sa herë ngritesh".

Vince Lombardi

Trendet e investimeve në Gjermani

Peizazhi i investimeve në Gjermani, në vitin 2024, karakterizohet nga disa tendenca kyçe, të ndikuara si nga sfidat e brendshme ekonomike ashtu edhe nga zhvillimet globale.

Sektori industrial i Gjermanisë, tradicionalisht një shtyllë e ekonomisë së saj, po përjeton një rënie. Kjo i atribuohet kostove të larta të inputeve dhe besimit të ulët industrial, të cilat kanë mbajtur nën trend rritjen e formimit të kapitalit. Investimi bruto fiks i vendit pritet të mbetet i ngadaltë, duke përkeqësuar më tej perspektivën ekonomike.

Kjo ka çuar në shqetësime për konkurrencën e Gjermanisë, veçanërisht përballë proteksionizmit në rritje dhe ndryshimit të dinamikës së tregtisë globale. Për më tepër, tensionet gjeopolitike dhe politikat ekonomike po riformësojnë mjedisin investues të Gjermanisë. Futja e një norme minimale globale të taksës së korporatave prej 15%, pritet të ndikojë në investimet e huaja direkte (FDI) në Gjermani, pasi kompanitë mund të jenë më pak të prirura për të investuar në juridiksione me taksa më të larta.

Pavarësisht këtyre sfidave, tregu i madh dhe i qëndrueshëm i Gjermanisë vazhdon të tërheqë investitorë afatgjatë, të cilët tërhiqen nga infrastruktura e saj e fuqishme, fuqia punëtore e kualifikuar dhe vendndodhja strategjike në Evropë.

Për më tepër, rritja e proteksionizmit ekonomik, veçanërisht në kontekstin e tregtisë me Kinën, po ndikon në tendencat e investimeve. Ndërsa modelet e tregtisë globale po ndryshojnë, ekonomia gjermane e drejtuar nga eksporti po ndjen presionin. Ndikimi i këtyre tendencave është i dukshëm në sektorë si logjistika, ku kompani të tilla si DHL po përshtaten me rrugët e reja tregtare dhe kostot më të larta që lidhen me tarifat dhe barrierat tregtare.

Si përmbledhje, ndërsa Gjermania përballet me erëra të rëndësishme ekonomike, duke përfshirë investimet e ulëta industriale dhe efektet e proteksionizmit global, bazat e saj të forta të tregut dhe pozicioni strategjik në Evropë vazhdojnë të ofrojnë mundësi për investitorët. Megjithatë, lundrimi në këtë mjedis do të kërkojë shqyrtim të kujdesshëm si të peizazhit ekonomik global ashtu edhe të zhvillimeve të politikës së brendshme.

UB
UNION BUSINESS
Albanisch & Deutsch

ME KËNAQËSI

MIRËPRESIM

ANËTARËT E RI TË UNIONIT TË BIZNESEVE SHQIPTARO-GJERMANE

albi MALL	PREMIUM+
AB Energy and Telecoms	GOLD
BIOALTA	PAKO SPECIALE
bio 365	PAKO SPECIALE
Ëmbëlsia M & A	PAKO SPECIALE
grasep	PAKO SPECIALE

UB
UNION BUSINESS
Albanisch & Deutsch

ME KËNAQËSI

MIRËPRESIM

ANËTARËT E RI TË UNIONIT TË BIZNESEVE SHQIPTARO-GJERMANE

HAIRFIX NATURALS	PAKO SPECIALE
HUUMë	PAKO SPECIALE
HV PRINT	PAKO SPECIALE
natural berry	PAKO SPECIALE
Punë n'dorë kep e shkep	PAKO SPECIALE
RAHAT	PAKO SPECIALE
MOBILJERIA TOWN	PAKO SPECIALE

AKTIVITETET E UBSHGJ

Unioni organizon panairin për biznese me pronare gra

Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane dhe Albi MALL, në kuadër të angazhimit për mbështetje të grave në biznes, organizuan panairin e bizneseve me pronare gra, një event unik që vuri në pah kreativitetin dhe suksesin e grave sipërmarrëse.

Shkelzen Jusaj

Në ceremoninë hapëse të panairit, të pranishmëve ju drejtuar z.Shkelzen Jusaj, Kryetar i Degës së UBSHGJ në Kosovë. Duke folur për kontributin e deritashëm të Unionit në komunitet dhe në funksion zhvillimit të ndërmarrësisë në mesin e grave, ai u shpeh se angazhimi rreth kauzave të tilla do të vazhdojë të mbetet në agjendën e Unonit. si një nga synimet madhore. Ai, në fjalën e tij, po ashtu përmendi trajtimin shumë kufizues ndaj gruas në të kaluarën, rolin e saj në formimin e shoqërisë, udhëheqjen e shtetit, përfaqësimin

ndërkombëtar në sport e kulturë, si dhe potencialin e jashtëzakonshëm që ka ajo për të ndikuar në zhvillimin ekonomik të vendit tonë..

Bekim Brestovci

Në fjalën e tij, Drejtori Ekzekutiv i Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, z.Bekim Brestovci, shprehu entuziazmin e ri për këtë format të panaireve, për të cilin u zotua se do të vazhdojë të aplikohet edhe në të ardhmen. Ai, po ashtu, tha se në të ardhmen do të organizohen edhe aktivitete të tjera, të cilat do t'i rrisin mundësitë e zhvillimit për gratë ndërmarrëse, duke mundësuar bashkëpunimin e tyre me anëtarët tanë në Gjermani e, rrjedhimisht, eksportimin e produkteve të tyre në tregun gjerman. Ashtu sikur z.Jusaj, edhe z.Brestovci u bëri thirrje grave ndërmarrëse që t'i bashkohen Unionit dhe të hapin perspektiva të reja për bizneset e tyre.

Fitore Osmani Muhaxhiri

Hapjen e panairit e përshëndeti edhe përfaqësuesja e Albi Mall, i cili këtë projekt e mbështeti pa asnjë hezitim. Znj. Fitore Osmani Muhaxhiri, shprehu kënaqësinë që Albi Mall është në mbështetje të grave në biznes dhe vuri në spikamë gatishmërinë e përhershme për të qenë në krah të projekteve të tilla. Ajo vlerësoi se fuqizimi i grave në biznes është çelësi i të ardhmes, jo vetëm për ekonominë, por edhe për tërë komunitetin tonë.

Në emër të grave pjesëmarrëse në panair, një fjalë rasti mbajti znj.Gresa Tahiri. Ajo tha se çdo sipërmarrje e udhëhequr nga një grua, është histori e guximit dhe e përkushtimit dhe është shembull i gjallë për atë që mund të arrihet kur të bashkohemi rreth një qëllimi të përbashkët.

Gresa Tahiri

Në këtë panair u ekspozuan produkte dhe shërbime unike nga sektorë të ndryshim si ushqim, pije, veshmbathje, shërbime grafike etj.

Biznese anëtare të Unionit marrin pjesë në panairin "Global Albanian Gastronomy Festival" - Kryesia e UBSHGJ i viziton ata

Në panairin "Global Albanian Gastronomy Festival", të mbajtur në Berlin me 2 dhe 3 tetor 2024, morën pjesë edhe disa anëtarë të Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane. Këto biznese, por jo vetëm, u vizituan nga anëtarë të kryesisë së UBSHGJ, të udhëhequr nga nënkryetari i saj z. Zenun Krasniqi.

Po ashtu, në këtë rast, u zhvilluan edhe shumë takime midis bizneseve anëtare të Unionit nga Kosova e Gjermania. Në të gjitha këto takime u diskutua lidhur me mundësitë e bashkëpunimit midis bizneseve që operojnë në këto dy shtete, me qëllim të hapjes së kanaleve për eksport të produkteve e shërbimeve nga Kosova në Gjermani. Në këtë drejtim kishte edhe marrëveshje konkrete, të cilat pritet të formalizohen në ditët në vazhdim. Nga anëtarët e Unionit në Kosovë, në panair u prezantuan me produktet e tyre: Frigo Deluxe, Albed, Relux, Kameleoni, Mercom Company, dhe Tiki, Punë n'dorë, HV Print, Grasep.

DRITARJA PËR INVESTIME TË DIASPORËS

Dritarja për investime të diasporës ka për qëllim që të mbështes investimet në ndërmarrësi private të themeluara nga bashkatdhetarët tanë që jetojnë dhe punojnë në vende të tjera.

NDËRMJETËSUESIT/BANKAT PARTNERE

Institucionet e regjistruara financiare të FKGK-së që kanë nënshkruar marrëveshjen e garancisë për Dritaren për Investime të Diasporës janë: Banka Ekonomike Sh.A., Banka Kombëtare Tregtare (BKT Kosova), Banka për Biznes Sh.A., NLB Bank Sh.A., ProCredit Bank Kosovo J.S.C., Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C, TEB Bank Sh.A.

ÇKA KONSIDEROJMË INVESTIM NGA DIASPORA DHE CILAT JANË KËRKESAT LIGJORE?

Bashkatdhetarët do të duhej të shprehin qëllim të qartë për të investuar në Kosovë:

- Duke iniciuar themelimin e një biznesi të ri, ose
- Duke përkrahur një biznes ekzistues në Kosovë themeluar nga investitori I diasporës.
- Bizneset që kanë përvojë më të gjatë se 36 muaj nuk kualifikohen për këtë dritare.

Struktura e pronësisë së bizneseve të sapo krijuara nga investitorët e diasporës, duhet të jetë në:

- Pronësi të plotë të investitorit të diasporës.
- Partneritet me banorë të Kosovës (shembull: partnerë biznesi, të afërmit e familjes, miqtë që jetojnë dhe punojnë në Kosovë) ose
- Nëse investitori nga diaspora themelon një biznes me një bashkinvestitor të huaj (jorezident të Kosovës).

Në të tri rastet e lartpërmendura, investitori nga diaspora duhet të zotërojë së paku 30% të pronësisë së ndërmarrjes. Investitori duhet ta mbështesë idenë e themelimit të biznesit/ndërmarrjes së re me një plan biznesi.

Pajtueshmëria me kërkesat dhe rregullativën ligjore:

Aplikuesit duhet t'i respektojnë të gjitha ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse që rregullojnë investimet dhe aktivitetet e biznesit në Kosovë. Për më tepër, aplikuesi do t'i nënshtrohet një procesi të vlerësimit të kujdesit të duhur kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga ana e institucionit të regjistruar financiar, dhe nuk duhet të jetë subjekt i ndonjë procesi gjyqësor ose pjesë e ndonjë liste të sanksioneve ndërkombëtare.

CILAT BIZNESE KUALIFIKOHEN?

Ndërmarrja mikro e vogël dhe e mesme (NMVM) kërkohet të jetë:

- Në pronësi private të themeluar nga investitori që gëzon statusin e investitorit nga diaspora.
- E regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK). Për më shumë informata ju lutemi që të klikoni: https://arbk.rks-gov.net/
- Ndërmarrje e themeluar nga diaspora që kanë përvojë pune jo më të gjatë se 36 muaj.
- Gjithëpërfshirëse për sektorë të ndryshëm përveç atyre të ndaluara sipas politikës së menaxhimit mjedisor e social të FKGK-së.
- Investitor me histori të mirë kreditore nga vendi përkatës ku jeton e vepron apo edhe në Kosovë.
- Biznes me më pak se 250 punonjës.

Info shtesë lidhur me origjinën Kosovare të pronarit të biznesit:

- ► Të gjithë ata që fillimisht kanë lindur dhe jetuar në Kosovë, por kanë emigruar dhe kanë jetuar për më shumë se tre vjet jashtë vendit.
- ► Pasardhësit (gjeneratat e reja) të prindërve kosovarë, duke u shtrirë në gjeneratën e dytë, me origjinë nga Kosova.

CILAT KREDI MUND TË PËRFITOJNË NGA DRITARJA PËR INVESTIME TË DIASPORËS?

Kreditë e Kualifikuara që plotësojnë kriteret e mëposhtme do të jenë të pranueshme për përfitime nga Dritarja për Investime të Diasporës:

- ► Shuma minimale e kredisë është 3,000 euro.
- ► Shuma maksimale e kredisë është 3,000,000 euro.
- ► Shuma minimale e garancisë është 1,500 euro.
- ► Shuma maksimale e garancisë është 2,000,000 euro.
- ► Afati minimal i kthimit të kredisë së garantuar do të jetë 3 muaj.
- ► Afati maksimal i kthimit të kredisë së garantuar do të jetë 84 muaj.
- ► Qëllimi i kredisë mund të jetë për investime të ndryshme afariste (asete fikse, pajisje, kapital qarkullues).

LLOJI I KREDISË

Kredi; Linjë kreditore; Mbitërheqje.

CILAT JANË KARAKTERISTIKAT E GARANCISË?

- ► Mbulueshmëri me garanci kreditore deri në 80% të kryegjësë së kredisë por jo më shumë se 2,000,000 euro. Përqindja e mbulueshmërisë me garanci kreditore varet nga vlera e investimit fillestar *
- ► Kufiri maksimal i humbjes 15% në nivel të portofolit.
- ► Pjesëmarrja e investitorit në investim fillestar është e obligueshme në vlerë së paku 20%.*

***Përqindja e mbulueshmërise me garanci sipas pjesëmarrjes në investim fillestar/kredi bankare**

Mbulueshmëria garancisë	Pjesëmarrja në investim fillestar/kredia bankare
60%	20/80%
70%	25/75%
80%	30/70%

CILI ËSHTË PROCESI I APLIKIMIT DHE VENDIMARRJES?

- ► Huamarrësi potencial (NMVM) nuk aplikon për garanci por aplikon për kredi në njërin nga institucionet e Regjistruara Financiare të FKGK-së.
- ► Institucioni i Regjistruar Financiar (IRF) pasi që të kryen analizat e zakonshme të kredisë duke zbatuar standardet e vlerësimit të riskut dhe nëse kompania i plotëson kriteret e FKGK-së atëherë IRF përkatëse e vendosë kredinë nën garancinë kreditore të FKGK-së .
- ► Pas vendosjes së kredisë përkatëse nga ana e IRF-së përkatëse në Sistemin për Menaxhimin e Informatave të FKGK-së, FKGK e pranon kredinë nën garancinë kreditore.

STATISTIKA / KOSOVË

Popullsia	Paga	Papunësia	BPV	Inflacioni
2024	2022	2023/TM4	2024/TM2	2024M08
1,586,659	**521 €**	**10.7 %**	**4.27 %**	**1.4 %**

Inflacioni (2021-2024)

Forma tabelare (%)

2024M08	2024M07	2024M06	2024M05	2024M04	2024M03	2024M02	2024M01	2023M12	2023M11	2023M10	2023M09	2023M08	2023M07	2023M06	2023M05	2023M04	2023M03	2023M02	2023M01	2022M12	2022M11
1.4	2.2	2.4	2.4	2.4	2.3	2.2	1.8	2.3	2.9	3.3	4.2	3.2	2.3	2.8	4.3	5.6	7.1	10.5	12.0	12.1	11.6

2022M10	2022M09	2022M08	2022M07	2022M06	2022M05	2022M04	2022M03	2022M02	2022M01	2021M12	2021M11	2021M10	2021M09	2021M08	2021M07	2021M06	2021M05	2021M04	2021M03	2021M02	2021M01
12.7	12.7	13.0	14.2	14.1	12.5	11.2	10.0	7.5	7.1	6.7	6.9	5.7	4.9	4.7	3.5	2.4	2.0	1.9	1.2	0.7	-0.2

Forma grafike (%)



(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Tregtia e jashtme

Eksporti sipas Broad Economic Categories (BEC) - (TM2/2024)

Vlera në (000)

Forma tabelare:

	2024M06	2024M05	2024M04
1: Ushqim dhe pije	13 207,468	13 720,064	11 256,699
2: Furnizimet industriale të paspecifikuara diku tjetër	36 280,762	42 584,459	36 090,709
3: Karburantët dhe lubrifikantët	2 172,106	4 284,290	2 420,926
4: Mallrat kapitale (përvec paisjeve të transportit) me pjesët dhe aksesorët e saj	3 909,087	3 934,814	4 341,468
5: Paisjet e transportit me pjesët dhe aksesorët e tyre	809,034	844,133	849,338
6: Mallrat e konsumit të paspecifikuara diku tjetër	16 763,003	20 317,588	18 236,686
7: Mallrat të cilat nuk janë të specifikuara diku tjetër	221,209	:	3,000

Forma grafike:



(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Importi sipas Broad Economic Categories (BEC) - (TM1/2024)

Vlera në (000)

Forma tabelare:

	2024M06	2024M05	2024M04
1: Ushqim dhe pije	94 648,148	98 971,642	96 754,498
2: Furnizimet industriale të paspecifikuara diku tjetër	139 338,641	154 045,833	146 080,586
3: Karburantët dhe lubrifikantët	49 274,818	54 179,237	57 102,381
4: Mallrat kapitale (përvec paisjeve të transportit) me pjesët dhe aksesorët e saj	64 078,470	59 489,633	53 009,561
5: Paisjet e transportit me pjesët dhe aksesorët e tyre	57 995,314	63 091,819	60 750,763
6: Mallrat e konsumit të paspecifikuara diku tjetër	89 719,847	85 912,131	86 401,000
7: Mallrat të cilat nuk janë të specifikuara diku tjetër	3 702,299	642,534	628,932

Forma grafike:



(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

A E DINI SE...

10 FAKTE RRETH EKONOMISË NËPËR BOTË

1 Ekonomia globale po rritet më ngadalë se më parë, kryesisht për shkak të ngadalësimit të rritjes në Kinë dhe faktorëve si lufta në Ukrainë dhe pandemia. Pritet që GDP-ja globale të rritet me rreth 2.7% në vitin 2024.

2 India është ekonomia që po rritet më shpejt, me një rritje të projeksionuar prej mbi 7% në vitet e ardhshme.

3 Sektori i teknologjisë po transformon ekonominë e Afrikës, veçanërisht në vendet si Nigeria dhe Kenia, ku fintech po zhvillohet me shpejtësi.

4 Brazil është eksportuesi më i madh global i produkteve bujqësore, duke përfshirë kafenë, sheqerin dhe sojën.

5 Vendet nordike (Norvegjia, Suedia, Danimarka) janë disa nga më të suksesshmet për sa i përket barazisë së pagave dhe cilësisë së jetës.

6 Emiratet e Bashkuara Arabe janë një nga qendrat kryesore të tregtisë globale, veçanërisht në Dubai, ku portet dhe linjat ajrore lidhen me tregje nga Azia në Evropë.

7 Industria e udhëtimeve dhe turizmit përbën rreth 10% të GDP-së globale, me vendet si Franca, SHBA dhe Spanja që janë ndër destinacionet kryesore turistike.

8 Luksemburgu ka GDP-në për frymë më të lartë në botë, falë sektorit të tij financiar të fuqishëm.

9 Rreth 1.6 miliardë njerëz në botë nuk kanë ende qasje në shërbime bankare tradicionale, duke krijuar potencial për zgjerimin e fintech dhe bankave dixhitale.

10 Tregu i teknologjisë së ripërtëritshme po rritet me 6% në vit, me energjinë diellore dhe të erës që udhëheqin investimet.

(Burimi: Census.gov)

STATISTIKA / SHQIPËRI



Import/Eksport (TM2/2024)

sipas grupmallrave

Vlera në LEK

		Vlera		
		2024-04	2024-05	2024-06
Ushqim, pije duhan	Importe	12.735.098.419	13.528.155.156	13.956.048.051
	Eksporte	5.104.697.340	5.441.430.150	4.880.306.224
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	Importe	7.766.715.206	7.504.358.662	7.628.161.480
	Eksporte	7.545.020.530	6.581.965.187	6.446.364.156
Produkte kimike dhe plastike	Importe	10.240.591.070	9.860.221.728	9.936.706.498
	Eksporte	1.444.342.677	1.275.790.711	1.217.372.359
Lëkure dhe artikuj prej lëkure	Importe	1.037.092.386	1.151.346.482	1.051.852.112
	Eksporte	214.096.857	153.976.351	175.367.821
Prodhime druri dhe letre	Importe	2.531.971.730	2.734.130.516	2.666.393.361
	Eksporte	881.584.868	826.387.181	826.126.101
Tekstile dhe këpucë	Importe	7.575.362.258	7.599.664.698	7.426.057.717
	Eksporte	9.371.288.058	9.379.360.479	9.264.134.240
Materiale ndërtimi dhe metale	Importe	10.073.077.474	11.523.634.758	11.297.168.081
	Eksporte	6.124.063.548	6.230.440.217	6.023.651.965
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	Importe	19.847.092.412	21.506.817.221	19.281.441.821
	Eksporte	3.012.278.063	3.421.399.663	3.265.855.073
Të tjera	Importe	3.495.988.692	3.897.608.100	3.433.331.761
	Eksporte	871.515.746	1.440.905.066	2.633.264.050

(Burimi: Instituti i Statistikave "Instat", Shqipëri)

TERMI i këtij numri

Startup

Startup-i është kompani ose organizatë në fazat fillestare të saj, që është krijuar për të zhvilluar një produkt, shërbim, ose ide inovative. Qëllimi kryesor i një S*tartup*-i është që të ofrojë diçka të re dhe të ndryshme nga ato që ekzistojnë në treg, dhe zakonisht vepron në një mjedis me paqartësi të madhe dhe rrezik të lartë. *Startup*-ët shpesh kanë potencial për rritje të shpejtë dhe përpiqen të gjejnë një model biznesi që mund të shkallëzohet, pra të përshtatet dhe të zgjerohet lehtësisht në tregje të reja.

Edhe *Startup*-i është një lloj ndërmarrjeje e re, por për dallim nga një ndërmarrje e re tradicionale, e cila mund të jetë një biznes lokal ose i vogël që operon me modele tashmë të provuara të biznesit, *Startup*-i karakterizohet nga inovacioni dhe rreziku i lartë. Ndërmarrjet e reja tradicionale, si për shembull një dyqan i ri rrobash ose një restorant i sapohapur, zakonisht kanë për qëllim të operojnë brenda një tregu ekzistues dhe me teknika të provuara të biznesit. Ato shpesh kanë rritje më të qëndrueshme dhe më të ngadaltë në krahasim me *Startup*-ët.

Ndryshe nga bizneset tradicionale, *Startup*-ët zakonisht financohen përmes investimeve private nga investitorë si *Angel Investors* apo *Venture Capitalists*, të cilët investojnë para në këmbim të aksioneve ose përfitimeve të ardhshme. *Startup*-ët shpesh fokusohen në teknologji, por ato mund të veprojnë në çdo industri.

Karakteristikat kryesore të një *Startup*-i dhe dallimet me një ndërmarrje të re tradicionale:

- **Inovacioni dhe modeli i biznesit:** *Startup*-ët synojnë të sjellin inovacione, ndërsa ndërmarrjet e reja shpesh ndjekin modele biznesi tradicionale;
- **Shkalla e rritjes:** *Startup*-ët janë të fokusuara në rritje të shpejtë dhe të qëndrueshme për t'u bërë ndërmarrje të mëdha, ndërsa ndërmarrjet e reja zakonisht kanë objektiva më modeste të rritjes;
- **Rreziku dhe paqartësia:** *Startup*-ët përballen me rrezik më të lartë për shkak të paqartësisë në lidhje me tregun dhe teknologjinë, ndërsa ndërmarrjet e reja operojnë në tregje të njohura dhe me më pak rrezik.

Përfundimisht, ndërsa të dyja fillojnë si biznese të reja, *Startup*-ët janë më inovative dhe shpesh përballen me një rrugë më të vështirë drejt suksesit, por edhe me mundësi më të mëdha për rritje dhe ndikim të gjerë në tregje.

STATISTIKA / GJERMANI

Bruto Produkti Vendor (BPV) - 2023

Viti/TM		me çmimet aktuale (miliardë euro)		çmimi i rregulluar chain-linked index (2015=100)	
		Vlerat origjinale	vlera e rregulluar kalendarike dhe sezonale duke përdorur X13 JDemetra+	Vlerat origjinale	vlera e rregulluar kalendarike dhe sezonale duke përdorur X13 JDemetra+
2024	II	1,065.51	1,078.68	103.34	104.78
	I	1,066.58	1,069.81	104.90	104.85
2023	IV	1,078.64	1,063.81	105.57	104.61
	III	1,048.71	1,052.40	104.96	105.00
	II	1,024.06	1,041.19	102.98	104.80
	I	1,034.14	1,029.72	105.72	104.96

(Burimi: Statistisches Bundesamt (Destatis))

Tregtia e jashtme

Eksporti

Mn EURO

Viti/muaji		Gjithsej eksporte	Industria e ushqimit (të gjitha së bashku)	Tregti dhe industri			
				Të gjitha së bashku	Lëndë e parë	Produkte gjysmë të gatshme	Produkte të gatshme
TM2 2024	Qershor	129,816	7,645	114,788	930	7,063	106,795
	Maj	129,653	7,996	115,673	982	7,507	107,184
	Prill	140,561	8,211	124,606	1,064	8,273	115,270

Importi

Mn EURO

Viti/muaji		Gjithsej importe	Industria e ushqimit (të gjitha së bashku)	Tregti dhe industri			
				Të gjitha së bashku	Lëndë e parë	Produkte gjysmë të gatshme	Produkte të gatshme
TM2 2024	Qershor	107,598	9,068	88,069	7,427	7,148	73,494
	Maj	106,960	9,722	90,001	7,442	7,657	74,902
	Prill	116,605	10,245	96,464	8,253	7,621	80,591

(Burimi: Statistisches Bundesamt (Destatis))

Renditja e partnerëve tregtarë të Gjermanisë në tregtinë e jashtme

(Viti 2023, renditja preliminare)

Eksport-Import

Rangimi	Eksport		Import	
	Destinacioni	në 1 000 Euro	Vendi i origjinës	në 1 000 Euro
1	ShBA	157 946 296	Kina	157 157 411
2	Franca	120 468 743	Holanda	104 817 808
3	Holanda	115 279 303	ShBA	94 672 235
4	Kina	97 332 811	Polonia	81 747 886
5	Polonia	91 927 500	Italia	72 169 229
6	Italia	87 138 673	Franca	69 847 022
7	Austri	81 947 095	Çekia	60 987 048
8	Mbretëria e Bashkuar	78 454 033	Austria	54 584 716
9	Zvicra	66 586 050	Belgjika	53 193 262
10	Belgjika	62 263 710	Zvicra	51 818 262

Qarkullimi dhe bilanci i tregtisë së jashtme

Rangimi	Qarkullimi (Eksport + Import)		Bilanci i tregtisë së jashtme (Eksport - Import)	
	Vendet partnere	në 1 000 Euro	Vendet partnere	në 1 000 Euro
1	Kina	254 490 222	ShBA	+ 63 274 061
2	ShBA	252 618 531	Franca	+ 50 621 721
3	Holanda	220 097 111	Mbretëria e Bashkuar	+ 41 775 163
4	Franca	190 315 765	Austria	+ 27 362 379
5	Polonia	173 675 386	Spanja	+ 15 344 223
6	Italia	159 307 902	Italia	+ 14 969 444
7	Austria	136 531 811	Zvicra	+ 14 767 788
8	Zvicra	118 404 312	Suedia	+ 11 317 770
9	Belgjika	115 456 972	Holanda	+ 10 461 495
10	Mbretëria e Bashkuar	115 132 903	Polonia	+ 10 179 614

(Burimi: Statistisches Bundesamt (Destatis))

ARSYET PËR TË INVESTUAR NË KOSOVË

Për kompanitë që kërkojnë të investojnë në një vend me shpenzime të vogla e me qasje të lehtë në BE, në Evropën Qendrore dhe në tregjet e Ballkanit, Kosova paraqet një mundësi shumë atraktive.
Në Kosovë, një investitor mund të regjistrojë biznesin për 2 ditë, falas me zero kapital çarter (për SHPK-të).

Regjimi i tregut të lirë

- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian (BE);
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me BE-në (mbi 500 milion konsumatorë);
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Evropën Qendrore (CEFTA) (përfshinë 7 vendet jo-anëtare të BE-së: Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Moldavinë, Malin i Zi dhe Serbinë - popullsia: 21 milion);
- Programi i Sistemit të Gjeneralizuar të Preferencave (Generalized System of Preferences (GSP) Program) me SHBA-në, Japoninë dhe Norvegjinë.

Kosto e ulët e operimit

- Paga mesatare bruto në sektorin privat është 473 €;
- TVSH: 8% për produktet bazë (shërbimet dhe shporta e ushqimit) dhe 18% për produktet tjera;
- Tatimi në dividendë: 0%
- Liberalizimi i importit:
  - Linjat e prodhimit dhe pajisjet për prodhim
  - Lënda e parë për prodhim (që nuk prodhohet në Kosovë)
  - Pajisjet e teknologjisë informative (TI);
- Sistemi Elektronik i Prokurimit
- Tatimi në të Ardhurat e Korporatave: 10%
- Tatimi mbi të Ardhurat Personale: 0 - 10 % (progresive)
- Kontributi pensional i detyruar: 5%

Sektorët që ofrojnë më shumë mundësi për investitorët e jashtëm janë:

- Bujqësia dhe Përpunimi i Ushqimit
- Përpunimi i drurit
- Ndërtimi
- Tekstili
- TI
- Komponentët e automobilave
- Turizmi
- Energjia dhe minierat

(Burimi: KIESA dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës)

TË ECIM BASHKË!

Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane është organizatë jofitimprurëse e themeluar në Gjermani, në tetor të vitit 2013. Ajo funksionon si shoqatë ombrellë e bizneseve dhe ofron një numër të madh shërbimesh në funksion të zhvillimit të tyre.

Unioni është rrjet i përhershëm i bizneseve dhe shërben si platformë e vazhdueshme për nxitjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet kompanive anëtare, stimulimin dhe lehtësimin e investimeve të jashtme direkte, përmirësimin e qasjes në financa dhe lehtësimin e eksporteve për kompanitë me bazë në Kosovë, përmes krijimit të urave të bashkëpunimit me bizneset e diasporës. Gjatë një dekade të veprimit të tij, Unioni ka arritur rezultate të dukshme si në kuadër të misionit të tij kryesor – nxitjes dhe lehtësimit të bashkëpunimit midis anëtarëve, ashtu edhe në ofrimin e kontributit për zhvillimin ekonomik, mbështetjes humanitare dhe atë të ngritjes së cilësisë së arsimit në vendet e origjinës.

Ne nuk do të ndalemi. Synimi ynë është e kundërta – rritja dhe shpejtimi i hapave. Por, këtë mund ta bëjmë vetëm nëse rritemi edhe vetë ne, sa më shpejtë. Dhe, pikërisht kjo është arsyeja pse ne kemi nevojë edhe për ju. Të ecim bashkë, të rritemi bashkë, të ecim më shpejtë!

Katalogu i përfitimeve të anëtarit

UB
UNION BUSINESS
Albanisch & Deutsch

	PREMIUM PLUS	PREMIUM	GOLD	SILBER	BRONZE
Krijimi i profilit të biznesit në platformë	●	●	●	●	●
Qasje në profilet e bizneseve anëtare të Unionit	●	●	●		
Publikimi i projekteve nga anëtarët e Unionit	●	●	●	●	
Ofertë për bashkëpunim nga anëtarët e Unionit	●	●	●		
Njoftim për mundësitë e investimeve në projekte në vendet e origjinës / publike dhe private	●	●	●		
Takime PREMIUM PLUS – takime mëngjesi/darke i anëtarëve Premium Plus	● x2	●			
Konsulencë ligjore në fushën e investimeve, rreth tatimeve dhe për investime përmes PPP (Kosovë)	●	●			
Mundësi aplikimi për fonde investimi	●	●	●	●	●
Njoftim i vazhdueshëm me risitë në politikat fiskale dhe ekonomike në vendlindje	●	●	●	●	●
Partneritet midis anëtarëve për investime të përbashkëta (konzorcium, shoqëri aksionare etj.)	●	●	●	●	●
Adresim i çështjeve të veçanta të investitorëve, anëtarë të Unionit, pranë institucioneve shtetërore	●	●			
Lobim tek institucionet shtetërore për ndryshimin e ligjeve apo politikave fiskale	●	●	●	●	●
Ndihmë në identifikimin e bashkëpunëtorëve potencial / lehtësim në krijimin e lidhjes	●	●	●		
Mundësi aplikimi për projekte investimi	●	●	●		
Njoftim për mundësitë e marrjes së granteve nga institucionet shtetërore dhe organizatat e huaja	●	●	●	●	●
Qasje në raportet vendore e ndërkomb. për ekonominë dhe të bërit biznes në vendlindje (publikim)	●	●	●	●	●
Vizita të organizuara në panaire	● x2	●	●	●	●
Pjesëmarrje në trajnime dhe punëtori	● x2	●	●	●	
Pjesëmarrje në takime B2B (Business to Business)	● x2	●	●		
Njoftim për aktivitetet që organizohen nga partnerët e Unionit	●	●	●		
Ndihmë teknike për vetorganizimin e aktiviteteve me anëtarë të caktuar të Unionit	●	●	●	●	●
Reklamim i bizneseve anëtare në platformën digjitale dhe rrjetet sociale të Unionit	●	●	●	●	
Info. dhe statistika rreth indikatorëve makroekonomik, eksport-import dhe investimeve të jashtme	●	●	●	●	●
ANËTARI PËR ANËTARIN (anëtari i Unionit përfiton zbritje nga anëtarët e tjerë)	●	●	●	●	●
PRIVILEGJI I ANËTARIT (Oferta speciale për anëtarë nga marrëveshjet e Unionit me palët e treta ekonomike)	●	●	●	●	
Marrja e referencave bazuar në performancën në platformë	●	●	●		
Mundësi për t'u bërë/për të gjetur distributor/agjent tregtar	●	●	●		
Pjesëmarrje në bashkëbisedim me personalitete të rëndësishme	●	●			
Pjesë e katalogut vjetor të anëtarëve	●	●	●	●	●
Sponsorim i reklamës së kompanisë në rrjetet sociale të Unionit	●				
Reklamim i aktivitetit/kompanisë përmes videos në platformë	●				
Prezantim i logos së kompanisë në çdo numër të Newsletter	●				
Prezantim të logos së kompanisë në signature të e-mailit zyrtar të Unionit	●				
Reklamimi i logos së kompanisë në platformëm digjitale (web)	●	●			

ANËTARË PREMIUM+

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AD Bau GmbH & Co KG
Hoch - und Tiefbau

AG BAU
QUALITAT IST UNSER ERFOLG

AK METALLBAU
Ihr kompetenter Partner in Stahl un Edelstahl

ALBED

ALBAclean
GLAS- UND GEBÄUDEREINIGUNG

ALBERTI

albi MALL

ALIUBAU GmbH

aip Alko - Impex
General Construction

A&M CLOTHES

ATOS Technische Hygiene GmbH

AT SCHWEISSTECHNIK GmbH
welding • parts • service

BAU-KO
Stuckateurbetrieb

BAULIG

BINNI

Blini GmbH
BAUUNTERNEHMUNG

Campus Garden
BUSINESSHOTEL & RESTAURANT

DAAKONN

Deutsche Investment Fund

Ecolog

EMTeQ GmbH

FATI GmbH

FLORIENG

FRIGO DELUXE

fumotec
Dienstleistungen GmbH.

GOCKELMOBIL

Hajdari
WDVS Trockenbau

Hazrolli
Unternehmensgruppe

heby Brandschutz GmbH

HYSENI SALES & CONSULTING GMBH

Hotel Neuenahrer Hof

HR ABBRUCH GMBH

Restaurant ILIRI

ImmoCenter AG

IZOVENT
• VENTILIM • KLIMATIZIM • TERMOIZOLIM

KELMENDI

KRASNIQI
GARTEN- UND LANDSCHAFTSBAU

KRASNIQI GMBH
Immer für Sie da

KAHN&Z ARCHITECTS

LIRIDONI

m-technologie
by mabetex group

N&Z Bauunternehmung GmbH

NUHA

Petrol Company

PROFASO
FASADER - MOLER - KNAUF

remos®

PROTEC
HIGH TECH PERFORMANCE

RRONIFER
GROUP

Selmans Network

Stockinger

POLIKLINIKA SHËNDETI IM

TONI COMPANI

Versicherungsmakler GmbH

VIBTIS

wolf
BAUUNTERNEHMEN

2B Projektentwicklung GmbH

Profili i anëtarëve

Shërbime	47.60 %
Ndërtimtari	35.46 %
Gastronomi	5.75 %
Tregti	2.24 %
Prodhim	3.83 %
Financa	2.88 %
Shëndetësi	1.60 %
Veshmbathje	0.64 %

Zotimi i bordit

"Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane do të jetë një urë e sigurt dhe një zë i fortë për anëtarët tanë, si në procesin e bashkëpunimit midis tyre, ashtu edhe në përfaqësimin e tyre në institucione, shoqata dhe kompani, në Gjermani dhe në vendet tona të origjinës".

UNION BUSINESS
Albanisch & Deutsch

ZYRA QENDRORE - GJERMANI
Tel. +49 (0) 211 88 250 220, +49 152 247 562 80

ZYRA NË KOSOVË
Tel. +383 48 735 734

info@union-business.de, www.union-business.de

"Nuk dua njerëz që më thonë vetëm atë që dua të dëgjoj. Dua që secili të thotë të vërtetën. Madje, edhe nëse kjo i kushton me vendin e punës"
Samuel Goldwyn

Paçi shëndet dhe suksese, në punë e në jetë!